



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201500411/8

Tiranë ____/____/2016

Lënda : *Rekomandojmë marrjen e masave organizative dhe ligjore për transferimin e shtetasit kosovar N. H. nga Republika e Shqipërisë, në Republikën e Kosovës*

Drejtuar : Zj.LLAMBRIOLA MISTO
Sekretare e Përgjithshme
MINISTRIA E DREJTËSISË

TIRANË

E nderuar Zj.Misto,

Në ankesën e tij datë 17.03.2015, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi kosovar N. H. i cili vuan dënimin me burgim në I.E.V.P. Lezhë, na shkruan se i ka drejtuar një kërkesë Ministrisë së Drejtësisë Tiranë, me anën e së cilës ka kërkuar transferimin e tij për të vuajtur pjesën e dënimit me burgim në Republikën e Kosovës dhe prej saj nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Në bazë të kërkesave të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", me shkresën tonë me Nr.K2/N4-2prot datë 25.03.2015, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë ju kërkuam shpjegime me shkrim se si qëndron ky problem dhe pse nuk është njoftuar ankuesi mbi procedurën e ndjekur nga ana juaj. Ministria e Drejtësisë Tiranë pasi ka trajtuar kërkesën tonë me datën 07.04.2015 na informon se Ministria e Drejtësisë ka inicuar procedurën e transferimit të shtetasit kosovar N. H. dhe se me shkresën e saj me Nr.N14-2prot datë 03.03.2015, drejtuar Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, ajo ka kërkuar transferimin nga Shqipëria në Kosovë të shtetasit kosovar N. H.

Me datën 06.11.2015 ankuesi N. H nga I.E.V.P. Lezhë ankohet përsëri tek Avokati i Popullit dhe pretendon se e drejta e tij për transferim nga Shqipëria në Kosovë po shkelet nga Ministria e Drejtësisë dhe me këtë rast ai kërkon ndihmën dhe ndërhyrjen e tij për realizimin e kësaj të drejte sa më shpejt të jetë e mundur, duke shfrytëzuar kështu dhe kompetencat dhe ndërhyrjet ligjore të parashikuara nga ligja në kryerjen e funksionit të mbrojtje të drejtave dhe lirive të njeriut.

Për këtë problem nga ana jonë janë dërguar 2 shkresa Ministrisë së Drejtësisë me datën 24.11.2015 dhe tjetra me datën 28.01.2016, dhe nga ana juaj nuk na ka ardhur përgjigje.

Në këto kushte duke analizuar kërkesën e ankuesit N. H. dhe se në rastin konkret konstatohet zvarritje pa shkaqe ligjore në trajtimin e kërkesës tij dhe po shkelet e drejta e transferimit të tij në shtetin amë, për të vuajtur dënimin me burgim sa më afër familjes së tij, menduam që të ndërhyjmë me rekomandim për realizimin e kësaj drejtës të ligjshme.

Në nenin 60/1 të Kushtetutës së Republikë së Shqipërisë, thuhet se: "Avokati i Popullit, mbaron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Në rastin konkret rezulton se ankuesi N. H. kërkesën e tij, për transferim e ka paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë Tiranë, me datë 20.02.2015, dhe akoma deri më sot datë 10.02.2016, ajo nuk ka bërë të mundur transferimin e tij në Republikën e Kosovës.

Në këto rrethana dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 63 pika 4 të Kushtetutës së RSH, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", dhe nenin 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar ku thuhet se, "Pas përfundimit të hetimit Avokati i Popullit, paraqet rekomandim për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administratës që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.

Pë sa më sipër, Ju

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave organizative dhe ligjore për transferimin e shtetasit Kosovar N. H. nga Republika e Shqipërisë, në Republikën e Kosovës.

2. Mbi masat e marra dhe qëndrimin mbi rekomandimin tonë, nga ana juaj lutemi të njoftohemi me shkrim brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI